



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



Nr. 14 prot  
06.11/04/2023

**VENDIM**

Nr. 12, datë 06.04.2023

**PËR**

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES ME NR.144/2 PROT, DATË  
12.03.2018, MIRATUAR ME VENDIM NR.3, DATË 07.03.12018  
"PËR PËRDORIM BURIMIT UJORË NËNTOKSOR PË QËLLIME  
SANITARE", TE SUBJEKTIT "STILJAN GUÇE", ME  
VENDODHJE: NJËSIA ADMINISTRATIVE BALLDRE, BASHKIA  
LEZHË, QARKU LEZHË**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e rinovimit të lejes Nr.144/2 prot., datë 12.03.2018, miratuar me vendim nr.3, datë 07.03.12018 "Për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime sanitare te subjektit "Stiljan Guçe", me vendndodhje: Njësia Administrative Balldre, Bashkia Lezhë, Qarku Lezhë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

X= 469956

Y= 4628263;

Z= 10 m.m.n.d

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për qëllime sanitare (Bar – Restorant Larje mjetesh motorike).

Sasia e ujit që jepet për përdorim:  $Q= 0.5$  l/sek

Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorura: Gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektiv.

**KRYETARI I KBU DRIN-BUNË**

**MAJLINDA ANGONI**

